



USAID | MACEDONIA
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**PËR QARKULLIM TË
MENJËHERSHËM**

7 maj, 2008

Zyra për shtyp: +389 (0)2 308-0446

Celulari: +389 (0)70 367 547

Email: bvelickovska@usaid.gov

KUMTESË PËR SHTYP

USAID-i investoi 62,000 dollarë për rinovimin e shkollave fillore në Ilinden dhe Çashkë

Populli amerikan, përmes projektit për Arsim Fillor të USAID-it (PEP) do t'i investojnë më shumë se 3 milion dollarë për të rinovuar mbi 100 shkolla fillore në gjithë vendin. Shkolla fillore "Goce Dellçev" në Ilinden dhe "Todor Janev" në Çashkë janë ndër përfitueset nga kjo ndihmë. PEP kontribuoi 33,000 dhe 29,000 dollarë për shkollat, respektivisht, për zëvendësimin e dritareve të vjetra të drurit me dritare të reja me korniza të aluminit për kursim të energjisë.

Ky projekt i suksesshëm nuk do të kishte qenë i mundur pa bashkëpunimin e shkëlqyeshëm midis PEP, dy komunave, dhe shkollave. Të gjithë partnerët kontribuan fonde për rinovim dhe morën pjesë aktive në zbatimin dhe mbikëqyrjen. Përfundimi i projekteve u festua me ceremoni të prerjes së shiritit më 7 dhe 8 maj, ku morën pjesë kryetarët e komunave, drejtorët e shkollave, dhe persona të tjerë të rëndësishëm nga USAID dhe PEP.

Komponenta e rinovimit e USAID/PEP mbështet krijimin e mjediseve më të mira për mësim, dhe decentralizimin e objekteve shkollore tek pushtetet komunale. Projekti gjithashtu punon për të rritur qasjen dhe përdorimin e teknologjisë informative dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit të matematikës dhe shkencës nëpër shkollat fillore në Maqedoni.

Shënim për redaktorët

Populli amerikan, përmes USAID, ka investuar afro 500 milionë dollarë në Maqedoni që nga viti 1993. USAID po zbaton projekte të cilat po krijojnë vende të reja të punës, zvogëlojnë korrupsionin dhe përgatisin studentët e Maqedonisë për fuqi pune. Këto nisma përmirësojnë cilësinë e jetës dhe përkrahin kalimin e Maqedonisë kah një demokraci e qëndrueshme. USAID siguron ndihmë ekonomike dhe humanitare në më shumë se 100 vende. Për më tepër informata ju lutemi vizitoni <http://macedonia.usaid.gov>.